

# RAPORT

## VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

( VNM paraprake)

### REHABILITIM I PLAZHEVE TE LIQENIT TE SHKODRES DHE NDERTIMI I INFRASTRUKTURES PER AKTIVITETE SPORTIVE

**Subjekti: BASHKIA SHKODER**

**Adresa: Bregu perendimor i liqenit te Shkodres**

#  
#  
#  
#  
#  
#  
#  
#  
#

**2014**

## **PASQYRA E LENDES**

### **1. HYRJE**

- 1.1. Te dhena te pergjithshme
- 1.2. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
- 1.3. Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

### **2. LEGJISLACIONI MJEDISOR DHE PERPUTHJET E TIJ ME PROJEKTIN**

- 2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
- 2.2. Legjislacioni kombetar
- 2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor
- 2.4. Kuadri institucional
- 2.5. Legjislacioni European per mbrojtjen mjedisore
- 2.6. Metodologjia e Vleresimit

### **3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT**

- 3.1. Te pergjithshme
- 3.2. Vendodhja e aktivitetit
- 3.3. Pershkrim i sheshit
- 3.4. Pershkrimi i aktivitetit
- 3.5. Instalimet e fuqise motorike dhe ndriçimit
- 3.6. Rrjeti i instalimeve hidraulike
- 3.7. Skema e tokezimeve dhe e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike
- 3.8. Masat kunder zjarrit
- 3.9. Statusi i zones se studiuar

### **4. KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE BIODIVERSITETIT**

- 4.1. Klima
- 4.2. Karakteristikat gjeologjike
- 4.3. Flora dhe fauna

## 5. NDIKIMET NE LARMINE BIOLOGJIKE

- 5.1. Konsiderata te pergjithshme mbi ndikimet
- 5.2. Indikatorët e ndikimeve te mundshme
- 5.3. Veshtrim i detajuar mbi ndikimet ne mjedis per veprimtarine
- 5.4. Matrica permbljedhese e ndikimeve ne mjedis
- 5.5. Ndikimet tek njerezit, ndertesat dhe objektet e ndertuara nga njeriu
- 5.6. Ndikimet ne uje
- 5.7. Ndikimet ne toke
- 5.8. Ndikimet ne ajer
- 5.9. Ndikime te tjera te mundshme ne mjedisin e zones

## 6. MASAT LEHTESUESE DHE MONITORIMI

## 7. ASPEKTI SOCIAL

## 8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- 8.1. Konkluzione
- 8.2. Rekomandime

## 1. HYRJE

### 1.1. Te dhena te pergjithshme

Qarku i Shkodrës është një ndër më të mëdhenjtë në Shqipëri. Ai shtrihet nga Alpet e Veriut tek ultësira bregdetare. Gjerësia gjeografike nga 42<sup>0</sup>50' (Boks, Velipoja) longitude dhe nga 19<sup>0</sup>54' (Dukagjini) tek 19<sup>0</sup>17' (Liqeni i Shkodrës) latitude. Vija kufitare ka gjatësinë 304 km, nga e cila 149 km i perkasin Malit te Zi. Afërsisht 80% e sipërfaqes janë male. Lartësia më e madhe është maja e Jezercës (2,694 m).

Klima është mesdhetare; temperatura mesatare vjetore varion nga 7.5 °C në Vermosh tek 14.8 °C në qytetin e Shkodrës. Temperatura në janar arrin nga -2.7 °C tek 5 °C; në korrik 17-18 °C tek 24.6 °C. Rënia mesatare vjetore e shirave shkon rreth 2000 mm, një nga më të lartat në Shqipëri. Vera është zakonisht e thatë.

Rajoni i Shkodrës është i njohur për burime të pasura hidrografike. Ne kete rajon gjenden lumenjte Drini, Buna, Shala, Kiri, Cemi, përrenj dhe burime te tjera ujore. Në perëndim të qytetit ndodhet liqeni i Shkodrës, liqeni më i madh në Ballkan, me 368 km<sup>2</sup>, prej të cilëve 169 km<sup>2</sup> i perkasin territorit shqiptar.

### 1.2. Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit te aktivitetit duke përfshirë kushtet fiziko-gjeografike dhe ato biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social–ekonomike të zonës. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të përfituara rishtas mbi kushtet e vendit te aktivitetit, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

### 1.3. Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuar në procesin e VNM-se përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së ujit, burimet tokësore dhe ujore, situatën social-ekonomike dhe kulturore gjatë zhvillimit të aktivitetit. Burimet e vlerësuara social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe hekurudhor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM-ja pershkruan gjithashtu edhe masat zbutëse për t'u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM), i cili është pjesë e raportit. VNM-ja e përbëhet nga tërësia e procedurave të funksionimit të veprës, monitorimit, zbutjes dhe masave institucionale që do të zbatohen gjatë funksionimit të aktivitetit të propozuar për të mënjeluar, kompensuar apo pakësuar sadopak ndikimet e kundërta potenciale mjedisore dhe sociale.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t'i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet e strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të duhur.

Vizioni i rajonit të Shkodrës është zhvillimi i qendrueshem duke patur si pikesynim të behet partner i Evropës. Me zhvillimin e qendrueshme kuptojmë jo vetëm rritjen industriale e si rrjedhim atë ekonomike, por krahas kësaj edhe mbrojtjen e mjedisit i cili është një element thelbësor dhe shumë i rëndësishëm për zhvillimin normal të aktiviteteve të ndryshme që influencojnë në mjedis.

Kjo kërkon që konsideratat shoqërore e ekologjike të ekuilibrohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë një zhvillim të qendrueshme për brezat e ardhshëm.

Mjedisi konsiderohet i pastër kur nuk përmban substanca të tjera të huaja, veç atyre që hyjnë në përzierje natyrore të tij. Kalimi nga një mjedis i pastër në atë të ndotur vëhet re kur substancat ndotëse arrijnë një koncentrim të demshëm për organizmin.

Korniza kryesore e kuadrit ligjor për përgatitjen e këtij raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis:

- Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”.

- Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

Metodologjia e perdorur per pergatitjen e raportit te VNM-se eshte bazuar ne:

- Rishqyrtimin e politikave, rregullave, udhezimeve operacionale dhe masave organizative institucionale ekzistuese ne Shqiperi per te zgjidhur dhe lehtesuar impaktet shoqerore dhe mjedisore te studimit;
- Vleresimin e perputhshmerise se parimeve baze te rregullave shqiptare duke identifikuar boshlleqet dhe duke paraqitur rekomandime per t’i zgjidhur ato;
- Pergatitjen e udhezimeve per identifikimin dhe vleresimin e natyres dhe magnitudes se impakteve mjedisore dhe sociale, duke perfshire pergatitjen e kriterereve seleksionuese sociale dhe mjedisore per te perzgjedhur projektet per implementimin dhe per te percaktuar nivelin e studimeve/vleresimeve sociale dhe mjedisore qe kerkohen;
- Sugjerimet mbi modalitetet per pergatitjen e masave lehtesuese te nenprojektit ne lidhje me zonen ku po ekzekutohet ky i fundit.

Institucionet pergjegjese kane ne organiken e tyre nje sere sektoresh si inspektoriate ashtu edhe teknike si ne nivelin qendror ashtu dhe ne ate rajonal si dhe specialiste te mjedisit, qe do te jene pergjegjes per monitorimin e ketij studimi dhe te vleresimeve te tjera mjedisore specifike si dhe do te trajtojne njesite e qeverisjes vendore per t’iu permbajtur kerkesave te parashtruara ne lejen mjedisore.

Per hartimin e raportit te VNM-se, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik te disponueshem, juridik e ekonomiko-financiar.

Sigurimi i kushteve natyrore te shendosha dhe mjedis te paster jane kusht shume i rendesishem per nje zhvillim rajonal shume te qendrueshem. Ato perbejne nje element baze per krijimin e nje klime ta favorshme ekonomike.

Rendesia e problemit te ndotjes se ajrit dhe kercenimeve te shendetit njerëzor, sot ne te gjithë botën është bërë shume e ndjeshme nga vet

zhvillimi tekniko ekonomik dhe sidomos ne ato vende qe merr zhvillim galopant industria.

Ne funksion te legjislacionit evropian ne mbrojtje te mjedisit eshte pershtatur edhe kuadri ligjor mjedisor i vendit tone, i cili eshte pasuruar me disa akte ligjore dhe nenligjore ne funksion te mbrojtjes se mjedisit. Gjithashtu ky ligj shoqerohet edhe me listat perkatese te aktiviteteve me ndikim ne mjedis.

## **2. LEGJISLACIONI MJEDISOR DHE PERPUTHJET E TIJ ME PROJEKTIN**

### **2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis**

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM-se. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM-se per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM-se:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara;
- Te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimmarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM-se mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM-se eshte te promovoje zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM-se:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efçence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit;
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

## 2.2. Permbledhje e kuadrit ligjor

Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

- Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr.10 440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”.
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.



- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
  - Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 për “Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
  - VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
  - VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”
  - V.K.M Nr.435 datë 12.09.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
  - Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008.
  - Ligji Nr.7875, datë 23.11.1994 “Per mbrojtjen e faunes se eger dhe gjuetine”, i ndryshuar me ligjin Nr. 9219 date 08.04.2004.
  - Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin Nr. 9791 date 23.07.2007.
- Ne parlamentin shqiptar jane miratuar edhe disa ligje ne kuader te perfshirjes se vendit tone ne Protokolle dhe marreveshje te ndryshme. Nder to permendim:
- Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: “Për ratifikimin e konventes se Aarhusit” Per te drejten e publikut per te pasur informacion dhe perfshirjen ne vendimarrje, si dhe per tju drejtuar gjykates per ceshtjet e mjedisit.
  - Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Kiotos” ne konventen per ndryshimet klimatike (UNFCCC).
  - Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit te vleresimit strategjik mjedisor”.
  - Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne Amendamentin e Pekinit per protokollin e Montrealit” Per substancat qe hollojne shtresen e Ozonit.
  - Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: “Për aderimin e Republikes se Shqiperise ne protokollin per regjistrat e shkarkimit dhe transferimit te ndotesve”
- Legjislacioni mjedisor vazhdon gjithashtu edhe me nje sere Vendime te Keshillit te Ministrave dhe Udhezime te Ministrit te Mjedisit.
- V.K.M. Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”
  - V.K.M. Nr.805, datë 4.12.2003 “Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore”
  - V.K.M. Nr.803, datë 4.12.2003 “Per standartet e cilesise se ajrit”
  - V.K.M Nr. 1189 date 18.11.2009,“Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”

- V.K.M Nr. 13, datë 4.1.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”
- Udhezim Nr.6, datë 27.11.2007, “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”.

### 2.3. Kuadri institucional

Institucioni kryesor dhe me i rëndësishem ne fushen e mjedisit është Ministria e Mjedisit. Ne varesi te kesaj ministrie jane edhe disa agjensi rajonale e qendrore, si dhe drejtorite e sherbimit pyjor.

Ministria e Mjedisit është autoriteti kryesor përgjegjes për menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e politikave mjedisore ne nivel kombetar. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit ne Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politiken e qeverise për mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nen-ligjore ne funksion te mbrojtjes dhe menaxhimit te qendrueshem te mjedisit, bashkerendon aktivitetet e institucioneve te linjes për ceshtje te mjedisit, organizon dhe koordinon punen për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt-marreveshjet nderkombetare apo bilateral për mbrojtjen e mjedisit, përgatit Raportin vjetor “Për Gjendjen e Mjedisit”, shqyrton dhe jep aktet e miratimit te lejeve mjedisore për aktivitetet e ndryshme ekonomike, etj.

Si institucion qendror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit dhe si mbështetëse teknike e Ministrisë, Ministria kryen edhe këto detyra kryesore:

- a. bashkëpunon me institucionet qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore e profesionale, për të rritur shkallën e zbatimit të legjislatcionit mjedisor;
- b. përgatit projektet e marrëveshjeve, të protokolleve e programeve të bashkëpunimit dy e shumëpalësh, me shtete, organe dhe organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre;
- c. studion nevojat e vendit për specialistë për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkërendon me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për kualifikimin e specializimin e tyre;
- d. mbështet projekte për punë kërkimore-shkencore, për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjike të pastra, për nxitjen e veprimtarive të organizatave jofitimprurëse mjedisore;
- e. ndihmon organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe për hartimin e zbatimin e planeve vendore për mjedisin.

Ne ligjin e ri per mbrojtjen e mjedisit, Nr. 10431, date 09.06.2011, ne Nenin 59 “Organizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” percaktohet:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.

4. Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.

5. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit.

Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:

- a. hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- b. përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;
- c. kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrisë;
- d. këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;
- e. krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;
- f. krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
- g. sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- h. sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

i sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësive mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;  
j menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.

Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.

Ne nivel prefekturë veprojnë 12 Drejtori Rajonale të Mjedisit (DRM), të cilat varen nga MeM. DRM-te kryejnë funksionet dhe kompetencat brenda territorit të një qarku të caktuar duke përfshirë të gjitha rrethet dhe komunat e bashkitë të këtij qarku.

Ne nivel vendor, bashkitë dhe komunat janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, megjithatë nuk kanë njësi të specializuara mjedisore përveç bashkitë të mëdha në vend.

Ne bazë të ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore Nr. 8652, datë 31.7.2000, autoritetet lokale moren përgjegjësinë për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e rezervave ujore, mbetjeve urbane, infrastrukturën e transportit dhe zonat e gjelbra.

Bashkitë dhe komunat janë gjithashtu përgjegjëse për menaxhimin e zonave pyjore të cilat kanë kaluar vitet e fundit me Vendim të Këshillit të Ministrave në administrimin e tyre.

## **2.4. Legjislacioni Europian për mbrojtjen mjedisore**

Proçesi i VNM-se do të marrë në konsideratë gjithashtu standartet evropiane të cilësive, sipas temës përkatëse, që përmbahen në Direktivat Evropiane që vijojnë:

- Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit Europian dhe këshillit e 21 Maj 2008 mbi cilësinë e ajrit në ambient dhe ajër me të paster për Europën;
- Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 15 Dhjetor 2004 përsa i takon arsenikut, kadmiumit, zhives, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike në ajrin e ambientit;
- Direktiva e Këshillit 1999/30/EC e 22 Prillit 1999 përsa i takon vlerave limit perdioksidin e squfurit, dioksidin e azotit oksidin e azotit, termijave plumbit në ajrin e ambientit;

- Direktiva 2002/60/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit e 25 Qershor 2002 persa i takon vleresimit dhe menaxhimit te zhurmes mjedisore;
- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Europian dhe Keshillit qe percakton nje kuader per veprimet e Komunitetit ne fushen e politikës se ujit;
- Direktive te Parlamentit Europian dhe te Keshillit per standartet e cilesise se mjedisit ne fushen e politikës se ujit dhe ndryshimi i Direktives 2000/60/EC [COM(2006) 398];
- Direktiva 2006/12/EC e Parlamentit Europian dhe e Keshillit 5 prill 2006 mbi mbetjet dhe Propozimi per nje direktive te Parlamentit Europian dhe te Keshillit 21 Dhjetor mbi mbetjet [COM(2005) 667].

## 2.5. Metodologjia e Vleresimit

Per hartimin e raportit te VNM-se, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik, inxhinierik dhe juridik. Ky projekt pergatitet me kerkese te investitorit, e gjithashtu jane kryer inspektime ne terren per identifikimin e elementeve mjedisore dhe te biodiversitetit.

MeM eshte autoriteti kompetent ligjor per te kerkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin e VNM-se, ku projekti ne vleresim do ti nenshtrohet procedurave te raportit te permbledhur te VNM-se, si shpjegohet ne menyre te detajuar si me poshte:

VNM-ja e permbledhur duhet te permbaje informacionin e me poshtem:

- a) Qellimi i projektit;
- b) Pershkrim i detajuar i objektivave;
- c) Te dhena mbi mjedisin ekzistues te zones dhe zonave te aferta me zonen ku do te zbatohet projekti;
- ç) Pershkrim i hollesishem i te gjithe instalimeve qe jane pjese e projektit ose qe do te perdoren gjate zbatimit te tij;
- dh) Pershkrim i veprave inxhinierike qe jane ndertuar ose zgjeruar dhe i punimeve te nevojshme per zbatimin e projektit;
- e) Ndikimet e mundshme mbi mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin ose zbutjen e tyre;
- e) Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit;

- f) Perputhjen e projektit me planin e rregullimit të territorit dhe me planin e zhvillimit ekonomik të zones ku do të zbatohet projekti;
- g) Permbledhje e konsultimeve me organet e qeverisjes vendore, organizatat jofitimprurese publike dhe mjedisore dhe të opinioneve të tyre;
- gj) Masat rehabilituese në rastet e ndotjes dhe demtimit të mjedisit si dhe kostove të tyre;
- h) Nje kopje të licencës të personit juridik ose organizatës që ka përgatitur raportin VNM.

Kjo duhet të mbështetet nga informacione në lidhje me karakteristikat e projektit, vendndodhjen e projektit (të dhëna për mjedisin, banorët dhe kulturen) dhe impaktin potencial të projektit, informacion i cili do të perdoret nga MeM dhe do të percaktojë nevojën për një VNM të permbledhur.

Raporti i thelluar i vlerësimit të ndikimit në mjedis, veç të dhënave të raportit të përmbledhur, përmban edhe:

- a) procedurën dhe arsyet e përzgjedhjes së vendit ku do të zbatohet projekti, përshkrimin, të paktën edhe të dy varianteve të tjera, për lokalizimin e projektit;
- b) masën e ndikimit të tij të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në mjedis;
- c) ndikimet e mundshme të varianteve në mjedis e shëndet;
- ç) rreziqet për aksidente me ndikim të rëndësishëm në shëndet e mjedis dhe masat për parandalimin e tyre;
- d) ndikimin ndërkufitar në mjedis, nëse ka;
- dh) planin e masave me karakter teknik, për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;
- e) përshkrime të hollësishme për përdorimin e qëndrueshëm të energjisë, të burimeve natyrore e minerare;
- ë) planin e bashkëbisedimeve të pritshme me organet e qeverisjes vendore, publikun e organizatat jofitimprurëse për mjedisin gjatë fazave të planifikimit, shqyrtimit dhe zbatimit të projektit.

### 3. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

#### 3.1. Te pergjithshme

Aktiviteti:	Rehabilitim i plazheve te liqenit te Shkodres dhe ndertimi i infrastruktures per aktivitete sportive
Subjekti:	Bashkia Shkoder
Adresa:	Bregu perendimor i liqenit te Shkodres, Shkoder.

Në kushtet e rritjes së atraksionit turistik në zonën Shirokë-Zogaj, Bashkia e Shkodrës, ka kërkuar hartimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues për këtë zonë, në mënyrë që jo vetëm të kontrollojë zhvillimin nganjëherë spontan e të pakontrolluar të këtyre zonave, por njëkohësisht të mbrojë e të promovojë vlerat e veçanta të tyre.

Ky plan është hartuar nga Bashkia Shkodër dhe GTZ në kuadër të projektit “Planifikimi Hapësinor i Rajonit Ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës, Shqipëri dhe Mal i Zi”. Kuadri ligjor mbi të cilin është bazuar ky plan është, ligji 8405, dt.17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar dhe VKM nr.722, dt.19.11.1998 “Për miratimin rregullores se urbanistikes”, i ndryshuar.

Bazuar në përcaktimet ligjore të cituara më sipër, studimi përmban:

Të dhënat, analizat e të dhënave dhe prognozatat

Objektivat dhe Strategjinë që Bashkia kërkon të arrijë, të ndara sipas zonave.

Mendimet, sugjerimet dhe propozimet e përfituara nga procesi i përfshirjes qytetare.

Përcaktimet që influencojnë mbi pronësinëmbi tokën dhe vlerësimin e saj, sipas funksioneve, mënyrës së zbatimit nëpërmjet studimit urbanistik pjesor, intensitetit dhe tipologjisë së ndërtimeve.

Klasifikimin në zona funksionale të territorit që përfshihet nga plani, duke u mbështetur në gjendjen ekzistuese, në përdorimet e mundshme, në dendësitë e banimit, në infrastrukturën inxhinierike e sociale, si edhe

rregullat që duhen ndjekur brenda secilës prej tyre për të ndryshuar destinacionin e përdorimit.

Shqyrtimin e zonave që do t'i nënshtrohen rikonstruksionit urbanistik, si edhe zonave për shtrirjen e qytetit.

Strukturën e përgjithshme organike të territorit nëpërmjet elementëve përcaktues të zhvillimit urban, veçanërisht nëpërmjet sistemit të përgjithshëm të komunikacionit rrugor, etj.

Përcaktimin e ndërhyrjeve për vlerësimin dhe ruajtjen e burimeve mjedisore, bujqësore, peizazhistike e historike, duke vendosur kushtëzime për përdorimin e tyre.

Parashikimet dhe drejtimet kryesore të vendosura prej studimit urbanistik rajonal.

Kufizime në lidhje me ndërtimet për:

- territore apo zona me ndërtime që paraqesin interes mjedisor, peisazhistik, historik e kulturor;
- mbrojtjen e funksionit të infrastrukturave dhe impianteve me interes publik.

Territoret e zonës Shirokë-Zogaj, me sipërfaqerespektive 66 ha dhe 80 ha, janë përfshirë brenda kufirit administrativ të qytetit të Shkodrës, që nga Janari i vitit 1997. Zona turistike e marre në studim është rreth 600 ha, dhe me një gjatësi vije ujore rreth 14.5 km, nga e cila rreth 10 km kanë breg shkëmbor dhe 4.5 km fushor. Studimi është mbështetur në Detyrën e Projektimit, e cila është hartuar nga Bashkia e Shkodrës, në bashkëpunim dhe asistencë nga GTZ dhe është miratuar në KRRT të Bashkisë Shkodër me Vendim nr. 3, date 02.11.2007.

### 3.2. Vendodhja e aktivitetit

Zona Turistike Shiroke - Zogaj shtrihet në perëndim të qytetit të Shkodrës. Kjo zonë kufizohet nga veriu me Liqenine Shkodrës, nga jugu me Malin e

Taraboshit, në perëndimi me kufirin shtetëror me Malin e Zi. Zona përfshin të tre llojet e relievit, malor kodrinor dhe sipërfaqe të karakterit fushor (e përqendruar pranë bregut të Liqenit).

Lartësia e nivelit të ujit të Liqenit të Shkodrës është e ndryshueshme. Kështu, në sezonin e shirave arrin në +10.00 m mbi nivelin e detit dhe në sezonin e thatësisë arrin në +06.00m. Thellësia mesatare e Liqenit është



10m. Sipërfaqja e Liqenit është 369 km<sup>2</sup>, nga të cilat 149 janë në territorin shqiptar dhe pjesa tjetër i takon Republikës së Malit të Zi.

Lartësia e Malit të Taraboshit është nga +569.0 m deri në +650.9 m mbi nivelin e detit në majën e Golishit. Pjerrësitë e terrenit lëvizin nga 10 - 20 % pranë bregut dhe 30 - 70 % në pjesën malore

Mbulesa pyjore dhe bimore e saj bën pjesë në zonën fitoklimatike të makies dhe dushqeve dhe është e vendosur mbi tokasedimentare-gëlqerore dhe toka magnetike ultrabazike.

Kjo zonë karakterizohet nga një sasi e madhe e orëve me diell dhe temperature të lartë, të cilat sjellin ulje të ndjeshme të lagështirës nëperiudhën e verës, pavarësisht nga prezenca e lagështisë së Liqenit të Shkodrës. Lagja Zogaj përmendet në hartat medicinale italianepër një mikroklima kurative për sëmundjen e astmës dhe disa sëmundjeve të tjera tëfrymëmarrjes.

### 3.3. Pershkrimi i aktivitetit

Sipas zerave te preventivit do te kryhen punime germimi per qellim sistemimin e ambjenteve mjedisore te zones. Sheshi do te pastrohet nga rrenjet, shkurret, shkembinj dhe cdo papasterti qe ka. Do te ndertohen shkallet qe te çojne prane bregut me guret natyror te zones.

Parashikohet ndertimi i murit mbajtes pergjate sheshit i cili do te jete me gur mozaik (sipas preventivit), do te kryhen punime germimi, mbushje dhe rrafshimi.

Per krijimin e ambjenteve rekreative, sheshi do te sheshohet ne disa pjese, do te mbillet tapet bari, do mbillen shkurre dekorative (Oleander) etj. Ne disa zona te sheshit eshte menduar te vishen me pllake per te mundesuar krijimin e vendeve per lojra dhe per pushim.

Sheshi do te ndricohet me ndricues dekorativ Elia (sipas preventivit).

Do te vendosen pontile galegjante ne disa pjese te zones sipas dimensioneve dhe formes te percaktuar ne projekt. Gjithashtu jane menduar te vendosen dhe elemente qendrimi per bicikletat, ne favor te turistave te zones. Ne sherbim te aktiviteteve sportive do te jene dhe 5 kabina druri me siperfaqe 20 m2.

Pergjate rruges do te behet vendosja e disa tabelave treguese me qellim qe ti sherbejne turizmit te zones.

#### 4. KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE DHE BIODIVERSITETIT

Meqenese zona ku do aplikohet ky projekt ndodhet ne brigjet e liqenit te Shkodres po japim disa konsiderata te pergjithshme te ketij liqeni.

Në studimet e fundit per liqenin e Shkodres është raportuar një numër prej 1100 mikroalgash, sipas Petkovic (1981), Rakaj, Hindak & Hindakova (2000), Rakocevic (2001) dhe Rakaj & Miho (2005). Reth 420 lloje i perkasin diatomeve, ku më me shumicë janë Navicula, Nitzschia, Cymbella, Gomphonema, Fragilaria, Achnanthes, Cyclotella etj. Llojet e kësaj gjinie janë gjendur si në plankton ashtu dhe në bentos. Klorofitet gjithashtu karakterizohen nga një diversitet i lartë. 470 lloje njihen nga ky grup për liqenin e Shkodrës, midis të cilave Pediasstrum, Scenedesmus, Tetraedron, Closterium, Cosmarium dhe Staurostrum gjenden më me shumicë. Grupe të tjera të përfaqësuar mirë janë gjithashtu Euglenophyta me Euglena, Phacus, Trachelomonas dhe Cyanophyta me Crococcus, Merismopedia, Microcystis dhe Oscillatoria.

Numri total i makrofiteve ujore në gjithë sipërfaqen e Liqenit të Shkodrës është 164 lloje që i perkasin 66 gjinive dhe 43 familjeve. Në bregun verior të liqenit komuniteti dominues i bimëve përfshin Scirpus – Phragmites (*Phragmites communis*, *Scirpus lacuster*, *Typha angustipholica*) si dhe Myriophyllum verticillati – Nuphar, ku llojet e *Nuphar*, *Ceratophyllum*, *Trapa* dhe *Potamogeton* jane me te perfaqesuara Bregu perëndimor i liqenit përbëhet nga shkëmbinj dhe kodra, me një bimësi submergjente. Përgjatë bregut lindor dhe jugor të liqenit është zhvilluar kallamishtja (*Phragmites*).

36 asosacione me bimë makrofite janë listuar për të gjithë liqenin nga Dhora 2005: Potamion, Najadetum marinae, Charetum fragilis, Charetum sp., Chareto – Nitellopsidetum obtusae, Potametum pectinati, Myriophylletum (spicatum – verticillatum), Potametum perfoliati, Potametum – Ranunculetum, Potametum lucentis, Potameto – Najadetum, Utricularietum vulgaris, Nympheion, Myriophyllo – Nupharetum lutei, Nymphoidetum peltatae, Nymphetum albo – lutea, Nymphaetum (alba), Hydrocharetum

(morsus – ranae), Ceratophylletum (demersum), Potametum natantis, Ranunculion, Ranunculetum fluitans, Phragmitetalia, Eleochari – Hippuridetum, Heterophylletum, Eleocharietum (pallustris), Sparganio – Glicerietum fluitans, Scirpetum (lacustris), Scirpeto – Phragmitetum, Phragmitetum (australis), Typhetum (angustifolia – latifolia), Menthetum aquatica, Ludwigietum palustris, Magnocaricietum, Juncetum and Agrostitetum (alba).

Krahas vlerave të biodiversitetit, kallamishtet dhe makrofitet e tjera janë gjithashtu të rëndësishme për aftësinë e tyre pastruese nëpërmjet mbajtjes së lëndës ushqyese dhe transformimit (azot, fosfor), si dhe lidhjes së ndotjesve. Cilësia e ujit të lumit Moraca përmirësohet duke kaluar përmes bimësise makrofite ligatinore përpara hyrjes në liqen.

Në brezat me shëlgje (*Salicetum alba*) rreth liqenit ndodhen pyjet më të dendur, kryesisht në bregun verior dhe në zonën që përmytet. Ato janë përdorur nga komuniteti lokal për dru zjarri, ndërtim dhe punime druri. Pyjet e dushkut të Shkodrës (*Quercus robur ssp. scutariensis*), të cilët në të shkuarën kanë pasur një përhapje të gjerë, janë degraduar. Komuniteti më i rendësishëm i pyllit përbëhet nga gështenja dhe dushku i butë (*Querceto castanetum montenegrinum*), *Quercetum confertae ceris*, si dhe *Carpinetum orientalis* me disa nenkomunitete. Vetëm pak breza të degraduar pyjore kanë mbetur nga pyjet dikur shumë të zhvilluar.

Për pjesën më të madhe të grupeve të inverteboreve të Liqenit të Shkodrës nuk ka studime të plota. Duke qënë se invertebrorët luajnë një rol të rëndësishëm ekologjik, mbi të gjitha si burim ushqimi për lloje të niveleve më të larta, mungesa e njohurive pengon në njohjen e saktë të funksionimit ekologjik të liqenit.

